

VENDIM
Nr.1014, datë 15.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.989, DATË 9.12.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCIVE CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË PËRBALLUAR SITUATËN E SHKAKTUAR NGA PËRMBYTJET NATYRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe të vendimit nr.968, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.989, datë 9.12.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Në shkronjën “a” fjalët “...shuma 300 000 000 (treqind milionë) lekë...” zëvendësohen me “...500 000 000 (pesëqind milionë) lekë...”.
 - b) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:
“ç) shuma 100 000 000 (njëqind milionë) lekë nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, miratuar për vitin 2010.”.
2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:
“Shpenzimet regjistrohen nga dega e thesarit në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Brendshme, në kapitullin 6 (Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit) dhe në klasifikimin ekonomik përkatës, në emër të institucionit të prefekturës.”.
3. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:
“6. Vendimi nr.971, datë 1.12.2010 i Këshillit të Ministrave “Për dhënie fondi për përballimin e situatës emergjente të krijuar në qarkun e Shkodrës, si pasojë e përmbytjeve natyrore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha